VENDIM
Nr. 87/2018

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PARLAMENTAR "PËR NDJEKJEN DHE MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 12/2018, "PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT"", NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË KUVENDIT PËR SIGURINË KOMBËTARE

(ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 55, datë 8.5.2019)[1]

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 67, të ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni parlamentar "Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme"".

II. Nënkomisioni organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare.

III. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".

IV. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

1.	Ermonela Valikaj (Felaj)	kryetare	(PS);
2.	_____	zëvendëskryetar	(PD);
3.	Pjerin Ndreu	anëtar	(PS);
4.	Elona Hoxha	anëtare	(PS);
5.	Sadi Vorpsi	anëtar	(PS);
6	_____	anëtar	(LSI);
7.	_____	anëtar	(PD).

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 19.7.2018

---

[1] Me vendimin e Kuvendit nr. 55, datë 8.5.2019 janë bërë këto ndryshime:
"1. Deputeti Myslim Murrizi caktohet zëvendëskryetar.
2. Deputetët Alban Zeneli dhe Ylli Shehu caktohen anëtarë."